



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo


Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

09Nr/2020 Rahovec, më datë: 22.07.2020

Për/Za/To:	Sanije Qelaj, Zyrtare e Larte për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve dhe Kultura lavërtarë - MBPZHR
CC	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Nga/Od/From:	Berat Duraku, Drejtor i DBPZHR-së
Subjekti/Predmet/Subject:	Korrje – shirjet 2020



RAPORTI I SHTABIT KOMUNAL PËR FUSHATËN E KORRJE-SHIRJES 2020

Në komunën e Rahovecit fushata e korrje-shirjes së drithërave ka filluar me datën **30.06.2020** në fshatin **Gur i Kuq**, ndërsa me datë 01.07.2020 ka filluar edhe në vendbanime tjera.

Shtabi komunal në vazhdimësi ka përcjellë punën e korrjeve, duke mbledhur informatat e nevojshme në lidhje me sasinë dhe sipërfaqet e korrura në secilin vendbanim. Si në vitet e kaluara edhe në këtë vit aktivitetet rreth fushatës së korrje-shirjeve i kanë vetë fermerët dhe auto-kombajnerët.

Gruri kryesisht është dorëzuar në mullirin e M-Sillostit në fshatin Xërxë, në fshatin Çifllak si dhe në pikën grumbulluese në qytetin e Rahovecit. Fal kushteve të mira klimatike fushata e korrje-shirjes këtë vit është duke u zhvilluar me sukses, ku pritet të përfundojë rreth datës **24.07.2020** përveç në disa ngastra që gjenden si të veçuar, fushata do të vazhdojë edhe për disa ditë. Sipas të dhënave të marrura nga fermerët, këtë vit rendimenti i grurit është i kënaqshëm si dhe cilësia është mjaftë e mirë. Në shumë zona të mbjellura me kulturën e grurit rendimenti mesatar ka qenë nga **4.000 deri në 8.000 kg**.

Në këtë fushatë janë angazhuar mbi **50 auto-kombanja**, ku shumica prej tyre ishin vendor ndërsa pjesa tjetër vinin kryesisht nga qytet fqinje. Çmimi për korrjen e **1 ha me grurë ishte 85 deri në 100 euro**, pasi që kjo varej nga zonat e ndryshme ku do të kryhej korrja e grurit.

Për të parë nga afër punën e korrje - shirjeve në terren ishte edhe Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi bashkë me Drejtorin e DBPZHR-së z. Berat Duraku ku kanë vizituar auto-kombajnatin dhe fermerët kultivues të grurit, duke ju uruar punë të mbarë dhe të palodhshme.

Në Komunën e Rahovecit fushata e korrjeve-shirjeve pothuajse është në përfundim, ku sipas Shtabit Komunal vlerësohet tepër e kënaqshme dhe e sukseshme si në rendiment, cilësi dhe në ecurinë e punës gjatë gjithë kohës.

Fermerëve ju urojmë bereqet dhe suksese në punën e tyre të palodhshme.






Foto: Vizita tek fermerët e ndryshëm gjatë fushatës së korrje-shirjeve.

Të dhënat rreth korrje–shirjeve të drithërave:

Komuna	Rahovec
Data e fillimit të korrje-shirjeve	22.07.2020.
Numri i autokombajnave	35 vendor Mbi 15 të huaj
Sipërfaqet e korrura me grurë (ha)	1.900 ha
Rendimenti mesatar i grurit (kg/ha)	4.000 – 8.000 kg/ka.
Sipas analizave në Laboratorin e licencuar në M-Sillosoi në Xërxë, gjendja e grurit në komunën e ton është kjo:	Lagështia e kokrrës së grurit 9-10.4 %, Masa hektolitare 75-76, Pa pastërtia 3.5 - 4 %.
Vështirësit gjatë korrje shirjeve	Nuk kemi pasur vështirësi në fushatën e korrje shirjeve, në përjashtim të disa defekteve të kombajnave gjatë procesit të korrjes së grurit

Shpresojmë që ditëve në vijim të mbizotëroj moti i mirë dhe të përfundojnë me suksese të gjitha korrjet e planifikuara.